E premte, më 10 qershor 1994

1. Në shkollën e mesme të mjekësisë „Dr. Ali Sokoli", një prind – Enver Sulejmani, u kërcënua dhe i fyri me fjalë më të ndyta asistentën e Matematikës vajzave të tij (ndonjë gjyle...), meqenëse kjo të kësaj shkolle u paska dhënë vetëm dyshja (2). Për këtë lajmëroi me telefon pedagogja Ajshe Bala.

2. Sot më lajmëroi me telefon drejtori i Gjimnazit Filologjik „Eqrem Çabej" në Prishtinë, Hasan Cervadiku, që rreth orës $10^{00}$ para banesës e ndaluan dy persona të panjohur serb e që kishin qenë punëtorë të Sigurimit serb dhe i kishin thënë që mos të lëshojë diploma dhe dëftesa me nënshkrimin dhe vulë të Kosovës se do të merren masa ndaj tij. Rreth orës $13^{00}$ si i inspektorët e Sigurimit ia kanë thënë sekretarit të shkollës e kanë kërkuar në shkollë.

3. Sot, lajmëroi Musli Krasniqi, drejtor i shkollës fillore „Minatori" në Novobërdë, rreth orës $14^{00}$ në shkollë kishin qenë dy inspektorë të Sigurimit serb nga Gjilani, të cilët e kishin kërkuar këtë (drejtorin). Kishin interesuar për vula dhe dëftesa. Meqenëse në shkollë nuk e kishin gjetur drejtorin, kishin lënë porosi ~~që ai~~ se të hënën përsëri do të vijnë në shkollë për ta kërkuar.